



Mësimi në Nivel Kolegji Fillon Tani

Të nderuar familjarë dhe kolegë,

Javën e kaluar vizitova shkollën e mesme World View në Bronx për të përgëzuar një grup nxënësish dhe arritjen e tyre emocionuese: fitimin e gjashtë ose më shumë krediteve mësimore në Lehman College. Ata nuk janë ende studentë kolegji, por po fillojnë të përgatiten për mësimin në nivel kolegji, falë programit [College Now](#) (Kolegj tani).

College Now (Kolegj tani) është një partneritet me City University of New York (CUNY) që u mundëson nxënësve të shkollave të mesme të regjistrohen në kurset e CUNY para se të diplomohen, duke i ndihmuar të kursejnë kohë dhe tarifat e shkollimit në të ardhmen.

Kjo është një nga mënyrat e shumta që Office of Student Pathways (Zyra për Rrugëtimet e Nxënësve) po ripërkufizon përgatitjen për kolegj dhe karrierë. Së bashku me iniciativa si [FutureReadyNYC](#) dhe [Career and Technical Education](#) (Arsim për karrierë dhe aftësi teknike), College Now (Kolegj tani) i pajis nxënësit me aftësitë, njohuritë dhe përvojën e nevojshme për të shkëlqyer si në arsimin e lartë, ashtu edhe në tregun e punës.

Në këtë periudhë të vitit, shkollat tona po mbështesin aktivisht maturantët për t'u përgatitur për hapat e tyre të ardhshëm. Mos harroni, të gjithë nxënësve që diplomohen nga NYC Public Schools (Shkollat Publike të Nju-Jorkut) u garantohej pranimi në një program të CUNY dhe tarifën e aplikimit për CUNY për nxënësit tanë janë hequr deri më 21 nëntor.

Për informacione të tjera dhe mundësi këshillimi, vizitoni [faqen tonë të internetit](#).

Falënderojmë CUNY-n, partnerët tanë të shumtë, familjet dhe stafin tonë, të cilët luajnë një rol thelbësor në krijimin e një të ardhmeje të guximshme për nxënësit tanë.

Në bashkëpunim,


Melissa Aviles-Ramos
Kancelare (Chancellor)

Fokusi i kancelares:

Ekipi i Office of Student Pathways (Zyra për Rrugëtimet e Nxënësve) është fokusuar maksimalisht në zhvillimin dhe mbështetjen e programeve si College Now (Kolegj tani) dhe FutureReadyNYC, duke siguruar që nxënësve t'u ofrohen mundësi cilësore që i ndihmojnë në rrugën drejt suksesit. Siç tha Kristen Harris, Drejtoresha Ekzekutive e Planifikimit për Kolegj dhe Karrierë (College and Career Planning): "Kur sistemet bashkohen me në fokus nxënësit, barrierat bien, mundësitë zgjerohen dhe çdo i ri mund ta shohë veten në një rrugë të qartë drejt të ardhmes së tij."

Nominoni një person ose program për fokusin e kancelares [këtu](#).

Video Kryesore:



Për përkthime, ju lutemi vizitoni faqen tonë në [YouTube](#).

Për të aksesuar titrat e përkthyer: Klikoni mbi ikonën "CC". Klikoni mbi ikonën "Settings (Cilësimet)" dhe zgjidhni "Subtitles/CC (Titrat/CC)". Zgjidhni "Auto Translate (Përkthim Automatik)" dhe më pas zgjidhni gjuhën tuaj.

Lajme dhe burime nga NYCPS:

- Arsimimi financiar është një komponent thelbësor për përgatitjen e nxënësve për të ardhme të guximshme. Shihni përmbajtjen tonë të re në [The Morning Bell](#), e cila është e fokusuar te [bazat e buxhetimit dhe këshillat mbi konsumin për të rinjtë](#).
- Për të reja dhe burime të tjera, ndiqni NYCPS online në [Facebook](#), [Instagram](#), [X](#) dhe [YouTube](#).
- Për përditësime javore me video nga Kryetari i Bashkisë Eric Adams, vizitoni faqen [YouTube të Zyrës së Kryetarit të Bashkisë](#). Mund gjithashtu [të regjistroheni për të marrë përditësime drejtpërdrejt nga Zyra e Kryetarit të Bashkisë](#).

Familje të NYCPS: Nëse nuk dëshironi më të merrni këtë buletin informativ, ju lutemi [çaktivizoni abonimin](#).